

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
REKTORI

Nr. 2695/11 Prot.

Tiranë, më 20 . 03 . 2023

URDHËR

Nr. 40, datë 20 . 03 . 2023

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR. 27, DATË 21.02.2023 "PËR SHPALLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJEN E DREJTUESVE TË NJËSIVE BAZË (DEPARTAMENTI I KIRURGJISË DHE NË DEPARTAMENTIN E OBSTETRIKË-GJINEKOLOGJISË) NË FAKULTETIN E MJEKËSISË, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË"

Në bazë të nenit 3, 39, 45 e vijues të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 5, 28, 29, 45 e vijues të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, nenit 4, nenit 5, pika 5, nenit 16, 22 të Rregullores së Zgjedhjeve në UMT, miratuar nga Senati Akademik me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 "Për miratimin e rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet, organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", i ndryshuar, në Urdhërin e Rektorit të UMT-së nr. 27, datë 21.02.2023 "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor për zgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë (Departamenti i Kirurgjisë dhe në Departamentin e Obstetrikë-Gjinekologjisë) në Fakultetin e Mjekësisë, në universitetin e Mjekësisë, Tiranë" si dhe në shkresën e Komisionit Institucional Zgjedhor të UMT-së nr. 238 prot., datë 20.03.2023 "Kërkesë për ndryshimin e datës së zgjedhjeve për drejtues të njësisë bazë në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë", protokolluar me tonën nr. 2695/10 prot., datë 20.03.2023,

URDHËROJ:

1. Ndryshimin e pikës 2 në Urdhërin e Rektorit të UMT-së nr. 27, datë 21.02.2023 "Për shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor për zgjedhjen e drejtuesve të njësive bazë (Departamenti i Kirurgjisë dhe në Departamentin e Obstetrikë-Gjinekologjisë) në Fakultetin e Mjekësisë, në universitetin e Mjekësisë, Tiranë", si më poshtë:

"2. Votimi për drejtuesit e njësive bazë të përcaktuara në pikën 1 (një) të këtij urdhri, do të zhvillohen më 27.03.2023".
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), Komisioni Zgjedhor i Fakultetit të Mjekësisë (KZF) dhe Fakulteti i Mjekësisë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të UMT-së.

REKTORI
ARBEN GJISIA

